d) të vërtetojë se automjeti, që kryen transportin, të jetë i pajisur me certifikatë "ADR", sipas legjislacionit në fuqi për transportin e lëndëve të rrezikshme dhe me GPS funksional për kontrollin dhe dokumen-timin e itinerarit në subjektin që bën transferimin;

dh) të ketë vërtetimin dhe aktin e kontrollit nga Shërbimi Vendor i Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin se automjeti që kryen transportin është i pajisur me shenjat konvencionale treguese për transport të këtyre artikujve, si dhe fikse zjarri jo më të vogla se 6 (gjashtë) kg dhe jo më pak se 2 (dy) copë;

e) rastet kur transferimi i mallit do të kryhet nga transportuesit e huaj me mjetet e tyre të transportit, të pajisur me certifikatë "ADR" në vendet e origjinës, si dhe rastet e transitivit të këtyre mallrave nëpërmjet territorit të Republikës së Shqipërisë përjashtohen nga shkronja "dh", e pikës 2, të këtij kreu;

ë) të ketë të deklaruar origjinën e mallit.

3. Pajisja me autorizim për asgjësimin e artikujve piroteknikë rregullon procedurën për lejimin e grumbullimi dhe asgjësimit të artikujve piroteknikë.

3.1 Operatori ekonomik, që kërkon të pajiset me autorizim për kryerjen e procedurës së asgjësimit të artikujve piroteknikë, duhet të plotësojë kushtet e mëposhtme:

a) të ketë licencë për prodhim, import, eksport apo autorizimin për transitim të artikujve piroteknikë, të lëshuar nga Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve ose licencën e tregtimit, shitjes me pakicë të lëshuar nga njësia administrative;

b) të ketë një marrëveshje me subjektet e licencuara nga Ministria e Mbrojtjes, të cilat ofrojnë edhe shërbimin e shkatërrimit/çmilitarizimit të lëndëve plasëse dhe municioneve ose marrëveshje me operatorin e licencuar për asgjësimin e artikujve piroteknikë, në përputhje me legjislacionin në fuqi për menaxhimin e mbetjeve të integruara;

c) të deklarojë sasinë, llojin, origjinën dhe arsyet e asgjësimit të artikujve piroteknikë.

KREU II
PROCEDURAT, AFATET, VLEFSHMËRITË DHE FORMATET PËR KËRKESËN DHE DHËNIEN E AUTORIZIMEVE PËR MAGAZINIMIN, TRANSFERIMIN DHE ASGJËSIMIN E ARTIKUJVE PIROTEKNIKË

Neni 4
Kërkesa për pajisjen me autorizim

1. Operatori ekonomik bën kërkesën për pajisje me autorizimin përkatës në portalin "*e-Albania*."

2. Operatori ekonomik pajiset elektronikisht te "Hapësira ime", në portalin "e-*Albania*", me dokumentin e autorizimit të lëshuar me vulë elektronike ose nënshkrim elektronik nga institucioni shërbimofrues.

Neni 5
Formati për kërkesën për pajisjen me autorizim, për magazinimin e artikujve piroteknikë

1. Kërkesa për marrjen e autorizimit për magazinimin e artikujve piroteknikë përmban:

a) emrin e operatorit ekonomik;

b) adresën e selisë së operatorit ekonomik;

c) të dhënat personale për administratorin dhe punonjësit, të cilët do të kryejnë veprimtari me artikujt piroteknikë. Të dhënat përfshijnë (emër, mbiemër, numër identifikimi, si dhe pozicionin e punës);

ç) adresën e vendndodhjes së magazinës;

d) llojin e artikujve piroteknikë, sipas kategorive të përcaktuara në ligj, si dhe kapacitetin maksimal të magazinës;

dh) afatin e përdorimit të magazinës, i përcaktuar nga komisariati i policisë ku ndodhet magazina.

2. Së bashku me kërkesën për lëshimin e autorizimit për magazinimin e artikujve piroteknikë, operatori ekonomik ngarkon në portalin "*e-Albania*" edhe këto dokumente shoqëruese:

a) fotokopjen e dokumentit të pronësisë të noterizuar, nëse është pronë e subjektit ose dokumentin që vërteton të drejtën e përdorimit, nëse objekti i magazinimit është në pronësi të një të treti;

b) vërtetimin nga komisariati i policisë përkatës, ku përcaktohet se objekti i plotëson kushtet për magazinimin e artikujve piroteknikë, sipas

përcaktimeve në rregulloren e teknikës së sigurimit për përdorimin civil të lëndëve plasëse në Republikën e Shqipërisë;

c) certifikatën e mbrojtjes nga zjarri, lëshuar nga Shërbimi i Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin.

Neni 6

Kërkesa për pajisjen me autorizim për transferimin e artikujve piroteknikë

1. Kërkesa për marrjen e autorizimit, për transferimin e artikujve piroteknikë, për përdorim civil përmban:

a) emrin e operatorit ekonomik;

b) adresën e selisë së operatorit ekonomik;

c) të dhënat për administratorin;

ç) adresën e vendndodhjes së magazinës dalëse dhe të magazinës pritëse;

d) itinerarin e lëvizjes;

dh) llojin, sasinë dhe fuqinë e artikujve piroteknikë që do të transferohen;

e) deklarimin e origjinës së mallit (të artikujve piroteknikë);

ë) të dhënat e automjetit që do të kryejë transferimin;

f) të dhënat e drejtuesit të mjetit;

g) të dhënat e shoqëruesit të pajisur me dëshminë e zjarrmëtarit;

gj) të dhënat e punonjësit të shërbimit privat të sigurisë fizike.

2. Së bashku me kërkesën për lëshimin e autorizimit për transferimin e artikujve piroteknikë, operatori ekonomik duhet të ngarkojë në sistem edhe këto dokumente shoqëruese:

a) Kopje të licencës për import, eksport apo prodhim të artikujve piroteknikë, lëshuar nga Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve ose licencën e tregtimit, shitjes me pakicë, të lëshuar nga njësia administrative;

b) Fotokopjen e dëshmisë së zjarrmëtarit, lëshuar nga organi përgjegjës që mbulon çështjet e infrastrukturës dhe energjetikës;

c) Certifikatën "ADR" të drejtuesit të mjetit, të lëshuar sipas legjislacionit në fuqi për transportin e lëndëve të rrezikshme;

ç) Certifikatën "ADR" të automjetit, të lëshuar sipas legjislacionit në fuqi për transportin e lëndëve të rrezikshme;

d) Kopje të kontratës me shërbimin privat të sigurisë fizike që kryen ruajtjen dhe sigurimin e automjetit;

dh) Vërtetimin dhe aktin e kontrollit, lëshuar nga Shërbimi Vendor i Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin për sinjalistikën e automjetit që do të kryejë transferimin;

e) Deklaratën e origjinës së mallit (të artikujve piroteknikë);

ë) Kopje të licencës të kategorisë III.2.B.

Neni 7

Kërkesa për pajisjen me autorizimin për asgjësimin e artikujve piroteknikë

1. Kërkesa për marrjen e autorizimit për asgjësimin e artikujve piroteknikë përmban:

a) të dhënat për administratorin e operatorit ekonomik;

b) vendin ku do të kryhet asgjësimi;

c) sasinë dhe llojin e artikujve piroteknikë që do të asgjësohen;

ç) datën dhe orën në të cilën do të kryhet asgjësimi.

2. Së bashku me kërkesën për lëshimin e autorizimit për asgjësimin e artikujve piroteknikë, operatori ekonomik duhet të ngarkojë në portalin "*e-Albania*" këto dokumente shoqëruese:

a) Marrëveshjen e lidhur me subjektet e licencuara nga Ministria e Mbrojtjes, të cilat ofrojnë edhe shërbimin e asgjësimit të lëndëve plasëse ose marrëveshjen e lidhur me operatorin ekonomik të licencuar për asgjësimin e artikujve piroteknikë, në përputhje me legjislacionin në fuqi për menaxhimin e mbetjeve të integruara;

b) Deklaratën e origjinës së mallit (artikujve piroteknikë);

c) Kopje të licencës për prodhim, import, eksport, të artikujve piroteknikë, të lëshuar nga Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve ose kopje të lejes së tregtimit, shitjes me pakicë, të lëshuar nga njësia administrative;

ç) Kopje të lejes mjedisore.

Neni 8

Verifikimi i dokumenteve dhe formatet e autorizimeve

1. Për pranimin, verifikimin dhe shqyrtimin e dokumenteve për autorizim, struktura përgjegjëse ndjek këtë procedurë:

a) Verifikon dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik, si dhe plotëson formularët përkatës, sipas rubrikave;

b) Verifikon besueshmërinë e kërkuesit, si dhe përgatit dokumentin e besueshmërisë dhe të përshtatshmërisë së personit, brenda 5 (pesë) ditëve.

2. Formati i kërkesës për pajisjen me autorizim dhe formati i autorizimit për magazinimin, transferimin dhe asgjësimin e artikujve piroteknikë janë sipas lidhjeve që i bashkëlidhen vendimit dhe janë pjesë përbërëse të tij.

Neni 9
Afati i shqyrtimit të kërkesës për pajisjen me autorizim

Afati për shqyrtimin e kërkesës për pajisjen me autorizim është:

a) 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e paraqitjes së kërkesës për pajisjen me autorizim për magazinim;

b) 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e paraqitjes së kërkesës për pajisjen me autorizim për transferim;

c) 10 (dhjetë) ditë nga dita e paraqitjes së kërkesës për pajisjen me autorizim për asgjësim.

Neni 10
Procedura e shqyrtimit, dhënies së autorizimit apo mospranimit të kërkesës për pajisjen me autorizim

1. Struktura përgjegjëse për dhënien e autorizimit, në rastet kur konstaton mangësi në paraqitjen e kërkesës apo mungesë të dokumentacionit, njofton operatorin ekonomik për plotësimin e tyre.

2. Operatori ekonomik brenda 10 (dhjetë) ditëve duhet të plotësojë mangësitë e konstatuara. Në këtë rast, afati i shqyrtimit pezullohet deri në plotësimin e mangësive të kërkesës nga ana e operatorit ekonomik.

3. Kërkesa për pajisjen me autorizim nuk pranohet nëse operatori ekonomik nuk plotëson mangësitë e dokumentacionit brenda afatit 10-ditor.

4. Në rastet kur struktura përgjegjëse miraton kërkesën për dhënien e autorizimit, vendimi i miratimit të kërkesës i dërgohet operatorit ekonomik në të njëjtën adresë dhe me të njëjtat mjete që ka aplikuar. Formati i autorizimit të lëshuar verifikohet në çdo rast kontrolli nga strukturat përgjegjëse, të përcaktuara në ligjin për lëndët plasëse për përdorim civil.

5. Në rastet e transferimit të herëpashershëm, struktura përgjegjëse kthen përgjigje për dhënie të autorizimit apo mospranim të kërkesës për autorizim për operatorin ekonomik me të njëjtat mjete, brenda të njëjtit afat që është bërë njoftimi nga operatori ekonomik.

6. Vendimi për mospranimin e kërkesës mund të ankimohet sipas procedurave të përcaktuara në Kodin e Procedurave Administrative.

Neni 11
Procedura e shfuqizimit dhe pezullimit të autorizimit

1. Përveç rasteve të përcaktuara në ligjin për artikujt piroteknikë dhe në ligjin për licencat, autorizimet dhe lejet, autorizimi për magazinimin, transferimin dhe asgjësimin e artikujt piroteknikë shfuqizohet edhe në rastet kur operatori ekonomik është në tejkalim, ka shkelur apo nuk përmbush më kriteret dhe kushtet e përcaktuara në këtë vendim.

2. Struktura përgjegjëse, në rastet kur gjatë verifikimit të veprimtarisë së operatorit ekonomik gjen shkelje të kushteve të përcaktuara në autorizim, pezullon autorizimin deri në verifikimin e rrethanave.

3. Struktura përgjegjëse kthen përgjigje më të njëjtat mënyra që është dërguar kërkesa për shfuqizimin e autorizimit, duke nxjerrë një vendim të arsyetuar.

4. Vendimi për shfuqizimin apo pezullimin e autorizimit mund të ankimohet sipas procedurave të përcaktuara në Kodin e Procedurave Administrative.

Neni 12
Vlefshmëria e autorizimit

1. Afati i vlefshmërisë së autorizimit për magazinim është deri në 2 (dy) vjet për objekte magazinimi të përkohshme dhe deri në 6 (gjashtë) muaj për objekte magazinimi javore apo ditore.

2. Për transferimet për çdo ngarkesë dhe çdo mjet që bën transportin e ngarkesës, afati i autorizimit për transferim është sa koha e kërkuar për transferimin.

3. Afati i autorizimit për asgjësim është i vlefshëm deri në 30 (tridhjetë) ditë.

4. Me mbarimin e afatit të vlefshmërisë së autorizimit, subjekti i interesuar për t'u pajisur sërish me këtë autorizim duhet të paraqesë kërkesën dhe dokumentacionin që provon përmbushjen e kushteve të autorizimit.

KREU III

Neni 13
Dispozita të fundit

Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria e Mbrojtjes, Agjencia Kombëtare për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera (AKSEM), Policia e Shtetit dhe Shërbimi i Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

Lidhja nr.1

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLICISË SË SHTETIT
DREJTORIA VENDORE E POLICISË_____
KOMISARIATI I POLICISË_____

A U T O R I Z I M

Për asgjësimin e artikujve piroteknikë

Bazuar në kërkesën nr._____datë _____ të subjektit _____ pajisur nga Ministria e Mbrojtjes/Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë me licencë/autorizim nr. _____datë_____, me administrator z._____ dhe drejtues teknik z. _____, me seli në_____, me adresë të magazinës_____, pas verifikimeve të kryera nga struktura e rendit të Komisariatit të Policisë_____ u konstatua se;

Ky subjekt ushtron aktivitetin për prodhimin/import/eksport/përdorimin e artikujve piroteknikë në qytetin_____, i cili është në juridiksionin e Komisariatit të Policisë _____dhe ka deklaruar se në magazinën e artikujve piroteknikë ka një sasi _____artikuj piroteknikë të skaduar, të cilat duhet asgjësuar.

Subjekti ka lidhur marrëveshje me subjektin e licencuar nga Ministria e Mbrojtjes për asgjësimin e artikujve piroteknikë të skaduar, i cili ofron këtë shërbimin në ambientin e caktuar nga subjekti i licencuar .

Shoqërimi i artikujve piroteknikë të skaduar do të kryhet nga shtetasi _____ i pajisur me dëshminë e zjarrmëtarit nr._____datë_____.

Subjekti ka në pronësi/qira automjet tip _____me targa _____për transportin e artikujve piroteknikë të skaduar, i cili plotëson kushtet e mbrojtjes nga zjarri dhe është pajisur me mjetet e nevojshme.

Subjekti ka lidhur kontratë me subjektin e SHPSF _____/Policinë e Shtetit për shoqërimin e automjetit që do të kryejë transportin e artikujve piroteknikë të skaduara.

Subjekti_____ autorizohet të asgjësojë artikuj piroteknikë si më poshtë;

1. Artikuj piroteknikë _____ton.

Afati i autorizimit është data_____

SHEFI I KOMISARIATIT

Lidhja nr.2

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLICISË SË SHTETIT
DREJTORIA VENDORE E POLICISË_____
KOMISARIATI I POLICISË_____

AUTORIZIM

Për magazinim të artikujve piroteknikë

Bazuar në kërkesën nr._____datë _____ të subjektit _____ pajisur nga Ministria e Mbrojtjes/Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë me licencë/autorizim nr. _____datë_____, me administrator z._____ dhe drejtues atë z. _____, me seli në_____, me adresë të magazinës_____, pas verifikimeve të kryera nga struktura e Rendit të Komisariatit të Policisë_____ u konstatua se;

Ky subjekt ushtron aktivitetin për prodhimin/import/eksport/përdorimin të artikujve piroteknikë në qytetin_____, i cili është në juridiksionin e Komisariatit të Policisë _____.

Subjekti plotëson kërkesat dhe është pajisur me vërtetimin e kolaudimit nga organi përgjegjës i Ministrisë së Industrisë dhe Energjetikës nr. _____datë dhe atë ne plotëson kushtet e mbrojtjes nga zjarri, pajisur me aktin nr._____datë___ ._____.

Magazina është e pajisur me kamera sigurie në bazë të kërkesave të ligjit "Për masat shtesë të sigurisë" dhe për ruajtjen dhe sigurinë e saj subjekti ka lidhur kontratë me subjektin e SHPSF_____.

Subjekti autorizohet të magazinojë artikuj piroteknikë sipas kapacitetit të magazinës, si më poshtë:

1. Artikuj piroteknikë _____ton.
2. _____

Afati i autorizimit është nga data ___deri më datë___ ._____

SHEFI KOMISARIATIT

Lidhja nr.3

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLICISË SË SHTETIT
DREJTORIA VENDORE E POLICISË_____
KOMISARIATI I POLICISË_____

AUTORIZIM

Për transferimin e artikujve piroteknikë

Bazuar në kërkesën nr._____datë _____ të subjektit _____, pajisur nga Ministria e Mbrojtjes/Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë me licencë/autorizim nr. _____datë_____, me administrator z._____ dhe drejtues teknik z. _____, me seli në_____, me adresë të magazinës_____, pas verifikimeve të kryera nga struktura e Rendit të Komisariatit të Policisë_____ u konstatua se;

Ky subjekt ushtron aktivitetin për prodhimin/import/eksport/përdorimin të artikujve piroteknikë në qytetin_____, i cili është në juridiksionin e Komisariatit të Policisë _____,
Subjekti është pajisur me autorizim për magazinim të artikujve piroteknikë nr._____datë_____ dhe subjekti pritës i mallit është pajisur me autorizim për magazinim të artikujve piroteknikë _____datë_____.

Transferimi i artikujve piroteknikë do të kryhet me automjetin tip _____me targa_____ dhe drejtuesi i mjetit _____ të cilët janë të pajisur me certifikatë ADR nr._____datë_____, plotësojnë kushtet e mbrojtjes nga zjarri dhe mjeti është i pajisur me mjetet mbrojtëse të nevojshme.
Shoqërimi i artikujve piroteknikë do të kryhet nga shtetasi _____ i pajisur me dëshminë e zjarrmëtarit nr._____datë_____si dhe nga punonjësi i SHPSF/Policia e Shtetit _____sipas kontratës.

Subjekti autorizohet të transferojë artikuj piroteknikë, si më poshtë;

1. Artikuj piroteknikë _____ton.
2. _____

Afati i autorizimit është data_____

SHEFI I KOMISARIATIT

Lidhja nr.4

KËRKESË
Për pajisjen me autorizim për asgjësim të artikujve piroteknikë

Drejtuar: Komisariatit të Policisë_____.

Unë _____administrator i subjektit _____i pajisur nga Ministria e Mbrojtjes/Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë me licencë/autorizim nr._____. "Për import/eksport/prodhim/përdorim të artikujve piroteknikë", me adresë të selisë_____, me drejtues teknik _____, me adresë të magazinës_____, paraqes kërkesën si më poshtë:

Ushtroj aktivitetin për prodhimin/import/eksport/përdorimin të artikujve piroteknikë në qytetin_____i cili është në juridiksionin e Komisariatit të Policisë _____.

Kam në pronësi/qira një magazinë në _____ për të cilën jam pajisur nga Policia e Shtetit me autorizim nr._____datë _____ për magazinimin e artikujve piroteknikë, me afat deri me _____

Në magazinë kam një sasi_____artikujve piroteknikë e cila është e skaduar, është jashtë përdorimit dhe duhet asgjësuar.

Kam lidhur marrëveshje me subjektin e licencuar nga Ministria e Mbrojtjes i cili ofron shërbimin e asgjësimit të artikujve piroteknikë. Asgjësimi do te kryhet në ambientin e caktuar nga subjekti i licencuar nga Ministria e Mbrojtjes për asgjësimin e artikujve piroteknikë të skaduar .

Shoqërimi i artikujve piroteknikë të skaduar do të kryhet nga shtetasi _____ i pajisur me dëshminë e zjarrmëtarit nr._____datë_____.

Subjekti ka në pronësi/qira automjet tip _____me targa _____për transportin e artikujve piroteknikë të skaduar i cili plotëson kushtet e mbrojtjes nga zjarri dhe është pajisur me mjetet mbrojtëse përkatëse.
Subjekti ka lidhur kontratë me subjektin e SHPSF _____/Policinë e Shtetit për shoqërimin e automjetit që do të kryejë transportin e artikujve piroteknike të skaduar.

Sa sipër, kërkoj të pajisem me autorizim për asgjësimin e artikujve piroteknikë të skaduar.

Bashkëlidhur, me kërkesën dorëzohen dokumentet që vërtetojnë plotësimin e kritereve për asgjësimin e artikujve piroteknikë.

KËRKUESI

Lidhja nr.5

KËRKESË
Për pajisjen me autorizim për magazinim të artikujve piroteknikë

Drejtuar: Komisariatit të Policisë_____.

Unë _____administrator i subjektit _____i pajisur nga Ministria e Mbrojtjes/ Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë me licencë/autorizim nr_____. "Për prodhim/import/eksport e përdorim të artikujve piroteknikë", me adresë të selisë_____, me drejtues teknik _____, me adresë të magazinës_____, paraqes kërkesën si më poshtë,.

Ushtroj aktivitetin për prodhimin/import/eksport/përdorimin të artikujve piroteknikë në qytetin_____, i cili është në juridiksionin e Komisariatit të Policisë _____.
Kam në pronësi/qira një magazine në _____, në të cilën do të magazinoj artikuj piroteknikë të llojit_____, me sasi_____ për një afat _____.
Magazina plotëson kërkesat dhe është pajisur me vërtetimin e kolaudimit nga organi përgjegjës i Ministrisë së Industrisë dhe Energjetikës nr._____datë _____dhe plotëson kushtet e mbrojtjes nga zjarri, për të cilën është pajisur me aktin nr.-_____datë_____.

Magazina ka një kapacitet magazinimi _____ton artikuj piroteknikë
Magazina është e pajisur me kamera sigurie në bazë të kërkesave të ligjit "Për masat shtesë të sigurisë dhe për ruajtjen dhe sigurinë e saj është lidhur kontratë me subjektin ë SHPSF_____.

Sa sipër, kërkoj të pajisem me autorizim për magazinimin e artikujve piroteknikë.

Bashkëlidhur, me kërkesën dorëzohen dokumentet që vërtetojnë plotësimin e kritereve për magazinimin e artikujve piroteknikë.

KËRKUESI

Lidhja nr.6

KËRKESË
Për pajisjen me autorizim për transferim të artikujve piroteknikë

Drejtuar; Komisariatit të Policisë_____.

Unë _____administrator i subjektit _____i pajisur nga Ministria e Mbrojtjes/ Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë me licencë/autorizim nr_____. "Për import/eksport/prodhim/përdorim të artikujve piroteknikë", me adresë të selisë_____, me drejtues teknik _____, me adresë të magazinës_____, paraqes kërkesën si më poshtë,.

Ushtroj aktivitetin për prodhimin/import/eksport/përdorimin të artikujve piroteknikë në qytetin_____e cila është në juridiksionin e Komisariatit të Policisë _____.
Kam në pronësi/qira një magazine në _____, për të cilën jam pajisur nga Policia e Shtetit me autorizim nr._____datë _____ për magazinimin të artikujve piroteknikë me afat deri më _____ dhe subjekti që pret mallin është i licencuar për ushtrimin e aktivitetit me artikujt piroteknikë dhe pajisur nga Policia e Shtetit me autorizim nr._____datë_____për magazinimin e artikujve piroteknikë, me afat deri me _____.

Transferimi i artikujve piroteknikë do të kryhet me automjetin tip _____me targa_____ dhe drejtues mjeti _____, të cilët janë të pajisur me certifikatë ADR nr._____datë_____. Mjeti plotëson kushtet e mbrojtjes nga zjarri dhe është i pajisur me mjetet mbrojtëse të nevojshme.

Shoqërimi i artikujve piroteknikë do të kryhet nga shtetasi _____ i pajisur me dëshminë e zjarrmëtarit nr._____datë_____, si dhe nga punonjësi i SHPSF/Policia e Shtetit _____sipas kontratës.

Subjekti ka lidhur kontratë me subjektin e SHPSF _____/Policinë e Shtetit për shoqërimin e automjetit që do të kryejë transferimin e artikujve piroteknikë.

Sa sipër, kërkoj të pajisem me autorizim për transferimin e artikujve piroteknikë.

Bashkëlidhur, me kërkesën dorëzohen dokumentet që vërtetojnë plotësimin e kritereve për transferimin e artikujve piroteknikë.

KËRKUESI

VENDIM
Nr. 238, datë 17.4.2024

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 395, DATË 9.6.2022, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR EMËRIMIN E ANËTARËVE TË KOMISIONIT TË NDIHMËS SHTETËRORE"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 16, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, "Për ndihmën shtetërore", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në pikën 1, të vendimit nr. 395, datë 9.6.2022, të Këshillit të Ministrave, nënndarjet " - znj. Delina Ibrahimaj – kryetar" dhe " - znj. Inida Methoxha – anëtar" zëvendësohen me " - z. Blendi Gonxhja – kryetar" dhe " - znj. Keida Qirko – anëtar".

2. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 239, datë 17.4.2024

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 17, DATË 15.1.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PROCEDURAT, KRITERET DHE RREGULLAT PËR ZBATIMIN E PROGRAMEVE TË NXITJES SË PUNËSIMIT NËPËRMJET PUNËSIMIT, FORMIMIT NË PUNË DHE PRAKTIKAVE PROFESIONALE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 11, të ligjit nr. 15/2019, "Për nxitjen e punësimit", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 17, datë 15.1.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin e programeve të nxitjes së punësimit nëpërmjet punësimit, formimit në punë dhe praktikave profesionale", të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

I. Në kreun II bëhen shtesat dhe ndryshimet, si më poshtë:

1. Pas fjalisë së parë, të pikës 1, shtohet fjalia, me këtë përmbajtje:

"Përjashtim nga ky kriter bëjnë vetëm të rinjtë, të moshës 15–29 vjeç, të cilët do të jenë pjesëmarrës sipas skemës së garancisë rinore dhe personat me aftësi të kufizuara.".

2. Pika 4 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"4. Punëdhënësit me të drejtë kërkese duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:

a) Të jenë persona fizikë apo juridikë të regjistruar, për jo më pak se 6 (gjashtë) muaj;

b) Subjekti të jetë në statusin aktiv;

c) Të mos kenë shkelur legjislacionin për punësimin në dy vjetët e fundit para kërkesës në program;

ç) Të ofrojnë punë me kohë të plotë, për një minimum prej 40 (dyzet) orësh në javë, me një pagesë mujore jo më pak se paga minimale, në përputhje me dispozitat e Kodit të Punës. Punësimi me kohë të pjesshme ose punët sezonale afatshkurtra nuk përfitojnë subvencionim;

d) Të jenë persona fizikë apo juridikë, të cilët nuk kanë detyrime të kontributeve shoqërore dhe shëndetësore, por në momentin e aplikimit në program kanë ende gjoba apo interesa të papaguar.

dh) Vendi i punës i financuar nga ky program duhet të vijë si rezultat i shtimit të vendeve të lira të punës në aktivitetin e punëdhënësit.".

3. Fjalia e dytë, e pikës 5, ndryshohet, si më poshtë vijon:

"Punëdhënësit me deri në 9 (nëntë) punonjës mund të aplikojnë për maksimumi 2 (dy) pjesëmarrës.".

II. Në kreun III bëhen këto ndryshime:

1. Në nënndarjen "ii", të shkronjës "ç", të pikës 1, bëhen këto ndryshime:

a) Paragrafi i dytë ndryshohet, si më poshtë vijon:

"- për 6 (gjashtë) muaj, për pjesëmarrësit, të cilët janë të rinj të moshës 15–29 vjeç, persona me aftësi të kufizuara, viktima të trafikimit, të dhunës në familje apo viktima të dhunës me baza gjinore, romë dhe egjiptianë, të kompensuara në muajin e katërt, të pestë, të gjashtë, të shtatë, të njëmbëdhjetë dhe të dymbëdhjetë të kontratës.".

b) Paragrafi i tretë shfuqizohet.

2. Nënndarja "iv", e shkronjës "dh", të pikës 2, ndryshohet, si më poshtë vijon:

"iv. pagesën për mentorin në vlerën 3 000 (tre mijë) lekë për çdo përfitues, pjesëmarrës të angazhuar nga ky punëdhënës, të kompensuar çdo muaj.".

3. Në pikën 4 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) Pas fjalëve "... viktimat e dhunës në familje ose të dhunës me bazë gjinore ..." shtohen "... përfituesit e rinj të moshës 15–29 vjeç, personat me aftësi të kufizuara dhe ...".

b) Në shkronjën "a", fjalët "... 1 600 (një mijë e gjashtëqind) ..." zëvendësohen me "... 1 800 (një mijë e tetëqind) ...".

c) Shkronja "b" ndryshohet, si më poshtë vijon:

"b) për prindërit e vetëm ose prindërit e rinj të moshës 18–29 vjeç me fëmijë nën 6 (gjashtë) vjeç jepet një bonus në vlerën prej 4 000 (katër mijë) lekësh në muaj për kujdesin e çdo fëmije në ngarkim;".

ç) Në shkronjën "c", pas fjalës "... të kufizuara" shtohen "..., në të cilën përfshihen, por pa u kufizuar, mjetet ndihmëse në vendin e punës, literaturë/informacion të përshtatur dhe përkthime për personat me dëmtime shikimi ose dëgjimi, asistent personal në vendin e punës, transport të përshtatur, aksesueshmëri të mjedisit të punës ...".

III. Në kreun IV bëhen këto ndryshime:

a) Pika 3 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"3. Pas marrjes së kërkesës nga punëdhënësi, verifikimet përkatëse për përmbushjen e kritereve të përcaktuara në pikën 4, të kreut II, për punëdhënësin, do të kryhen nga Sistemi i Shërbimeve të Punësimit nëpërmjet ndërveprimit me bazën e të dhënave shtetërore të institucioneve të tjera.".

b) Pika 4 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"4. Për punëdhënësit që plotësojnë kriteret, struktura vendore e punësimit, brenda 7 (shtatë) ditëve punë, identifikon listën e pjesëmarrësve punëkërkues të papunë, që plotësojnë kriteret e pjesëmarrjes në program.".

c) Pika 13 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"13. Financimi i punëdhënësit do të bëhet çdo muaj, brenda 10 (dhjetë) ditëve punë, pas dorëzimit të kërkesës për muajin që kërkon financim.".

IV. Në pikën 4, të kreut V, fjalët "... 5 (pesë) ..." zëvendësohen me "... 10 (dhjetë) ...".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 240, datë 17.4.2024

PËR DHËNIEN E MIRATIMIT PËR LIDHJEN E KONTRATËS SË QIRASË, ME TARIFËN 1 EURO/KONTRATA, NDËRMJET MINISTRISË SË EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT, SI QIRADHËNËS, DHE FONDACIONIT "FUNDJAVË NDRYSHE", SI QIRAMARRËS, PËR PASURINË SHTETËRORE NR. 969/15, ZONA KADASTRALE 1263, ME EMËRTIM PRONA NR. 98 "GRUP-DEPO, ISH-REPARTI USHTARAK NR. 5011", ME VENDNDODHJE NË BRAR, TIRANË, ME SIPËRFAQE TË PËRGJITHSHME 16 214 m², NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË MINISTRISË SË MBROJTJES

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të nenit 5, të aktit normativ nr. 4, datë 9.7.2008, të Këshillit të Ministrave, "Për privatizimin dhe dhënien në përdorim shoqërive tregtare dhe institucioneve shtetërore të ndërmarrjeve apo objekteve të veçanta, mjeteve kryesore dhe mjeteve të xhiros së këtyre ndërmarrjeve", miratuar me ligjin nr. 9967, datë 24.7.2008, të ndryshuar, dhe në vijim të pikës 3/a, të kreut V, të vendimit nr. 54, datë 5.2.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënien e miratimit për lidhjen e kontratës së qirasë, me ofertë të pakërkuar, me tarifën 1 euro/kontrata, ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, si qiradhënës, dhe fondacionit "Fundjavë Ndryshe", si qiramarrës, për pasurinë shtetërore nr. 969/15, zona kadastrale 1263, me emërtimin "Prona nr. 98 'Grup-depo, ish-

reparti ushtarak nr. 5011"', me sipërfaqe të përgjithshme 16 214 (gjashtëmbëdhjetë mijë e dyqind e katërmbëdhjetë) m², nga ku sipërfaqe ndërtimore 3 138.34 (tre mijë e njëqind e tridhjetë e tetë pikë tridhjetë e katër) m², me vendndodhje në Brar, Tiranë, në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Mbrojtjes, me afat 20 (njëzet) vjet, sipas genplanit dhe tekstit të kontratës, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Ministria e Mbrojtjes dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ZYRA E NOTERISË TIRANË
Nr. _____ rep.
Nr. _____ kol.

KONTRATË QIRAJE

Në Tiranë, sot më _____, të muajit _____, të vitit _____, (_____), u paraqitën para meje, noterit _____, palët kontraktuese, si më poshtë vijon:

Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, përfaqësuar me autorizim të titullarit të institucionit "qiradhënës", nr. _____ nga z./znj. _____, me detyrë _____, në Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, i datëlindjes __.__._____, banues në _____, me shtetësi shqiptare, i/e pajisur me letër njoftimin nr. _____, që më poshtë do të quhet "QIRADHËNËSI";

dhe

Subjekti "Fondacioni 'Fundjavë Ndryshe'", me seli qendrore në Tiranë, me adresë: _____, regjistruar si person juridik _____-_____dhe pajisur me nr. NUIS: L61315453U, përfaqësuar nga z./znj._____, i biri/bija i/e _____, i datëlindjes __.__._____, lindur në _____ dhe banues në _____, me shtetësi _____, identifikuar me letër njoftimin personal me nr. _____, që më poshtë do të quhet "QIRAMARRËSI".

Institucioni "qiradhënës", me propozimin nr. ____, datë ___.___._____, të _____, mbështetur në vendimin nr. 54, datë 5.2.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e kritereve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurive shtetërore", të ndryshuar, në zbatim të vendimit nr. ____, datë __.__.____ të Këshillit të Ministrave, "Për dhënien e miratimit për lidhjen e kontratës së qirasë me tarifën 1 euro/kontrata, me ofertë të pakërkuar", ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, si qiradhënës, dhe fondacionit "Fundjavë Ndryshe", si qiramarrës, për pasurinë nr. 969/15, zona kadastrale1263, me emërtimin prona nr. 98, "Grup-depo, ish-reparti ushtarak nr. 5011", me sipërfaqe të përgjithshme 16 214 m², me vendndodhje në Brar, Tiranë, në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Mbrojtjes, dhe bazuar në nenet 801–825 të Kodit Civil, si dhe kërkesës së fondacionit "Fundjavë Ndryshe", së bashku me "qiramarrësin", palët bien dakord të hartojnë këtë kontratë, me kushtet, si më poshtë:

Neni 1
Objekti i kontratës

Objekti i kësaj kontrate është dhënia me qira e pasurisë shtetërore nr. 969/15, zona kadastrale 1263, me emërtimin "Prona nr. 98, 'Grup-depo, ish-reparti ushtarak nr. 5011'", me vendndodhje në Brar, Tiranë, në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Mbrojtjes, me sipërfaqe të përgjithshme 16 214 (gjashtëmbëdhjetë mijë e dyqind e katërmbëdhjetë) m², nga ku sipërfaqe ndërtimore 3 138.34 (tre mijë e njëqind e tridhjetë e tetë pikë tridhjetë e katër) m², sipas genplanit dhe dokumentit të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, bashkëlidhur kontratës.

Neni 2
Qëllimi i përdorimit

Qëllimi i kësaj kontrate është dhënia në gëzim të përkohshëm i objektit të përcaktuar në nenin 1, për zgjerimin dhe rikonstruksionin e Qendrës së Solidaritetit, në ndihmë të shtresave në nevojë, që ndodhet në Brar, pranë fillimit të Rrugës së Arbrit, Tiranë.

Neni 3
Kohëzgjatja

Kjo kontratë është e vlefshme për 20 (njëzet) vjet dhe hyn në fuqi me nënshkrimin e saj nga palët.

Neni 4
Të drejtat dhe detyrimet e qiradhënësit

4.1 "Qiradhënësi", nëpërmjet Komandës Mbështetëse, në varësi të Ministrisë së Mbrojtjes, si njësia që ka në administrim pasurinë shtetërore, dorëzon, brenda një muaji nga hyrja në fuqi e kësaj kontrate, pronën e përcaktuar në nenin 1 të saj, të lirë për t'u shfrytëzuar për qëllimin e kësaj kontrate. Në momentin e dorëzimit do të hartohet procesverbali i dorëzimit të objektit që jepet me qira, i shoqëruar me foto, që është pjesë përbërëse e kontratës.

4.2 "Qiradhënësi" ka të drejtë të kontrollojë në çdo kohë për respektimin e kushteve të kësaj kontrate nga ana e "qiramarrësit".

4.3 "Qiradhënësi" ka të drejtë që, në çdo kohë gjatë kohëzgjatjes së kontratës, nëpërmjet njësisë monitoruese të kontratës së qirasë, Komandës Mbështetëse, të monitorojë kontratën për verifikimin e zbatimit të kushteve të përcaktuara në të.

4.4 "Qiradhënësi" është i detyruar të garantojë "qiramarrësin" për gëzimin e qetë të sendit, objekt të kësaj kontrate ndaj të tretëve, të cilët mund të ngrenë pretendime për të drejtën e tyre mbi këtë pronë.

4.5 "Qiradhënësi" ka të drejtë të kërkojë zgjidhjen e kontratës kur qiramarrësi shkel detyrimet e marra përsipër, duke njoftuar këtë të fundit 30 ditë përpara me shkrim.

4.6 "Qiradhënësi" nuk është i detyruar të garantojë qiramarrësin nga shqetësimet e të tretëve që nuk pretendojnë të kenë të drejta mbi pronën.

Neni 5
Të drejtat dhe detyrimet e qiramarrësit

5.1 "Qiramarrësi" ka të drejtë që, sipas legjislacionit në fuqi, të përdorë e të gëzojë pronën e marrë me qira dhe përmirësimet e bëra në të për të gjithë kohën që është në fuqi kjo kontratë.

5.2 "Qiramarrësi" ka për detyrë që të përdorë sendin, objekt të kësaj kontrate, për qëllimin e parashikuar në nenin 2, në përputhje me detyrimet ligjore, që rrjedhin nga legjislacioni shqiptar.

5.3 "Qiramarrësi" detyrohet që, në pasurinë e marrë me qira, të realizojë aktivitetin sipas nenit 2, të kësaj kontrate, duke investuar sipas fazave dhe vlerave të shprehura në planbiznesin e paraqitur në ministrinë përgjegjëse për ekonominë.

5.4 "Qiramarrësi" detyrohet të shfrytëzojë dhe të mirëmbajë objektin e kontratës së qirasë.

5.5 "Qiramarrësi" detyrohet të përballojë me shpenzimet e tij detyrimet që lidhen me dëmet e shkaktuara eventualisht palëve të treta.

5.6 "Qiramarrësi" detyrohet të sigurojë objektin e kontratës së qirasë, nëpërmjet policës së sigurimit.

5.7 "Qiramarrësi", në funksion të zhvillimit të aktivitetit, në territorin objekt i kësaj kontrate, do të investojë për zgjerimin dhe rikonstruksionin e Qendrës së Solidaritetit, në ndihmë të shtresave në nevojë. Sipas planbiznesit të paraqitur në ministrinë përgjegjëse për ekonominë, ky investim i "qiramarrësit" do të realizohet, si vijon:

Ky projekt parashikohet të ndërtohet në dy faza:

Faza e parë: Subjekti ka parashikuar të kryejë investime për ndërtimin e magazinës për administrimin e ndihmave materiale, për të qenë sa më pranë personave dhe familjeve në nevojë, si edhe për të përmbushur funksionin social të fondacionit. Në funksion të këtij objekti shërbimi social do të ndërtohet e gjithë infrastruktura ndihmëse, pra rrugët e brendshme, parkimi, muri rrethues. Do të investohet gjithashtu për forcimin e argjinaturës lumore, si dhe rrethimin për sigurimin e pronës. Kjo fazë do të zgjasë 36 muaj, duke filluar nga momenti i marrjes në dorëzim të objekteve dhe daljes së lejeve përkatëse që mundësojnë fillimin e punimeve. Vlera e investimit parashikohet të shkojë në 98 839 935 lekë.

Faza e dytë: parashikohet të përfundojë ndërtimi i zonës rekreative për fëmijë, e cila do të zgjasë deri në përfundim të afatit 5-vjeçar nga data e firmosjes së kontratës me vlerë investimi 13 328 219 lekë.

Investimi parashikohet të përfundojë brenda 60 muajve nga data e lidhjes së kontratës së qirasë dhe parashikohet, që vlera totale e investimeve do të jetë në vlerën 112 168 154 (njëqind e dymbëdhjetë milionë e njëqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë e njëqind e pesëdhjetë e katër) lekë.

Në total, në të dy fazat do të investohet **112 168 154** (njëqind e dymbëdhjetë milionë e njëqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë e njëqind e pesëdhjetë e katër) lekë.

5.8 "Qiramarrësi", sipas parashikimit për punësimin të shprehur në planbiznesin e paraqitur detyrohet që, në objektin e marrë me qira, **niveli i punësimit** do të jetë i ndarë në tri faza:

- Në fazën e parë, që do të zgjasë 36 **(tridhjetë e gjashtë) muaj**, duke filluar nga momenti i marrjes së lejeve përkatëse nga institucionet shtetërore, do të punësohen 31 punonjës.

- **Në fazën e dytë**, që do të zgjasë 24 **(njëzet e katër muaj) muaj,** do të punësohet edhe 19 punonjës të tjerë.

Në total, do të punësohen 50 (pesëdhjetë) punonjës, në përfundim të 5 vjetëve nga fillimi i punimeve pas marrjes së lejeve përkatëse.

Pavarësisht parashikimeve të realizimit si më sipër, monitorimi dhe përllogaritjet e afateve të realizimeve të punësimit të parashikuar transferohen në kohë gjithmonë pas datës së lejeve përkatëse të nevojshme për punime, ngritjen e aktivitetit dhe vënien në jetë të tij. "Qiramarrësi" detyrohet të zbatojë legjislacionin në fuqi "Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi".

5.9 "Qiramarrësi", në funksion të qëllimit, sipas nenit 2, dhe zhvillimit të aktivitetit, në territorin objekt i kësaj kontrate, në realizimin e treguesve të marrë përsipër, sipas neneve 5.7 dhe 5.8, detyrohet që të pajiset me leje ndërtimi dhe vendimet përkatëse mjedisore nga organet kompetente.

5.10 "Qiramarrësi" detyrohet që, para përfundimit të vitit të pestë të përdorimit të objektit me qira, sipas kësaj kontrate, të paraqesë para qiradhënësit shtesën e planbiznesit për treguesit e periudhës në vijim, brenda objektit të kontratës dhe pa ulur treguesit e shprehur në pikat 5.7 dhe 5.8 të kësaj kontrate.

5.11 "Qiramarrësi" detyrohet të paraqesë te "qiradhënësi", në fillim të çdo viti, relacion me shkrim lidhur me vlerat e investimeve, të paraqitura në pasqyrat financiare vjetore të subjektit, shoqëruar me relacionin përkatës të hartuar nga eksperti kontabël i miratuar, vërtetuar me çdo dokumentacion të vlefshëm, si dhe vërtetimin nga institucionet shtetërore përkatëse për numrin e të punësuarve në objektin e marrë me qira.

5.12 "Qiramarrësi" detyrohet që në momentin e përfundimit të kësaj kontrate të dorëzojë pronën të padëmtuar.

5.13. "Qiramarrësi", në përfundim të kësaj kontrate, ka të drejtë të heqë përmirësimet e ndashme nga prona, por pa e dëmtuar atë. "Qiradhënësi" nuk bën kompensimin financiar të investimeve në pasuri të paluajtshme të kryera nga "qiramarrësi".

5.14 Në ngarkim të "qiramarrësit" janë të gjitha tatimet dhe detyrimet që rëndojnë mbi pronën e dhënë me qira.

5.15 "Qiramarrësit" nuk i lejohet që pronën e dhënë me qira ta japë me nënqira ose t'ia kalojë kontratën një tjetri.

5.16 "Qiramarrësi", në funksion të qëllimit dhe zhvillimit të aktivitetit, sipas nenit 2, të kësaj kontrate, në territorin objekt i kësaj kontrate, në realizimin e treguesve të marrë përsipër, sipas neneve 5.7 dhe 5.8, detyrohet që të pajiset me lejet ose autorizimet përkatëse nga organet kompetente të parashikuara nga legjislacioni shqiptar.

5.17 "Qiramarrësi" në asnjë rast nuk mund ta rëndojë me barrë pronën objekt kontrate.

Neni 6
Pagesa e qirasë

6.1 "Qiramarrësi" detyrohet t'i paguajë "qiradhënësit" detyrimin e kontratës, në vlerën 1 (një) euro. Pagesa simbolike bëhet para se të firmoset kontrata.

6.2 Para nënshkrimit të kontratës, "qiramarrësi" ka paguar garancinë e kontratës, në vlerën 2 243 364 (dy milionë e dyqind e dyzet e tre mijë e treqind e gjashtëdhjetë e katër) lekë, sipas faturës së lëshuar nga "qiradhënësi", e cila qëndron e ngurtësuar në llogarinë përkatëse në buxhetin e shtetit, deri në përfundim të investimit të shprehur në nenin 5.7, të kësaj kontrate. Garancia kthehet pas përfundimit të investimit.

Neni 7
Penalitetet

7.1 Në rastin kur "qiramarrësi", në përfundim të çdo faze, sipas përcaktimeve në pikën 5.7, të kësaj kontrate, nuk realizon vlerën e investimit, do të penalizohet me gjobë, në masën 10 për qind të vlerës së investimit të parealizuar. Nëse, pas 6 muajve, investimi vazhdon të mos realizohet, "qiradhënësi" zgjidh kontratën dhe gjobit "qiramarrësin" me vlerën e garancisë së ngurtësuar në momentin e lidhjes së kësaj marrëveshje kontraktore.

7.2 Në rastin kur, "qiramarrësi", në përfundim të çdo faze, nuk ka realizuar nivelin e punësimit të përcaktuar në pikën 5.8, të kësaj kontrate, penalizohet me gjobë, në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë për çdo vend pune mesatar vjetor të pahapur.

Neni 8
Zgjidhja e kontratës

8.1 Kontrata zgjidhet me mbarimin e afatit të përcaktuar në pikën 3, të kësaj kontrate.

8.2 Kontrata mund të zgjidhet para afatit:

a) në marrëveshje midis palëve;

b) kur prona humbet tërësisht ose dëmtohet për shkak të një force madhore;

c) kur "qiramarrësi" shkel detyrimet e marra përsipër në nenet 5 dhe 6, të kësaj kontrate;

ç) kur "qiramarrësi" shkel detyrimet e marra përsipër në nenin 5.7, të kësaj kontrate;

d) kur prona nevojitet për interes publik.

8.3 Kontrata pushon automatikisht së vepruari 30 ditë pas njoftimit me shkrim të "qiradhënësit" për zgjidhjen e kontratës para afatit, sipas pikës 8.2 të saj dhe nëse "qiramarrësi" nuk ka reaguar me shkrim.

Neni 9
Përgjegjësitë e palëve

9.1 Palët përgjigjen për mosrespektimin e kushteve të kësaj kontrate.

9.2 Në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, në përfundim të investimit, pas relacionit të paraqitur nga "qiramarrësi", sipas pikave 5.7 dhe 5.8, të kësaj kontrate, palët janë të detyruara të bëjnë akte rakordimi të përbashkëta ndërmjet administratorit të pasurisë, Komandës Mbështetëse, në varësi të Ministrisë së Mbrojtjes, për nivelin e investimeve dhe punësimit të realizuar, sipas vlerave të paraqitura në pasqyrat financiare të subjektit, shoqëruar me relacionin përkatës të hartuar nga eksperti kontabël i miratuar.

9.3 Palët, "qiramarrësi" dhe "institucioni administrues dhe monitorues i kontratës së qirasë", Komanda Mbështetëse, në varësi të Ministrisë së Mbrojtjes, janë të detyruar që çdo vit të bëjnë akte rakordimi të përbashkëta për realizimin e kushteve të kontratës, në nivelin e punësimit, në nivelin e investimit dhe shlyerjen e penaliteteve ose gjobave (në rastet kur ka të tilla) të vendosura, sipas neneve të kësaj kontrate.

9.4 Me "forcë madhore" do të kuptohet një ngjarje që është jashtë kontrollit të palëve, si: tërmetet, përmbytjet, lufta. Në këto raste, palët janë të detyruara të njoftojnë njëra-tjetrën me shkrim. Koha e parashikuar për plotësimin e detyrimeve do të zgjatet për aq kohë sa do të vazhdojnë këto rrethana.

9.5 "Qiramarrësi" përjashtohet nga detyrimet për kohën e vazhdimit të forcës madhore dhe moskryerjes së aktivitetit për këtë shkak. Kjo periudhë do të përcaktohet me marrëveshje midis palëve.

Neni 10
Dispozita të fundit

10.1 Për gjithçka që nuk është shprehur posaçërisht në këtë kontratë, palët do t'u referohen dispozitave të Kodit Civil në fuqi.

10.2 Pjesë të kësaj kontrate janë planbiznesi i paraqitur në ministrinë përgjegjëse për ekonominë dhe procesverbali i marrjes në dorëzim të objektit, sipas kontratës së qirasë.

10.3 Mosmarrëveshjet që mund të lindin mes palëve gjatë zbatimit të kësaj kontrate do të zgjidhen me mirëkuptim dhe në rast se kjo është e pamundur, palët kanë të drejtë t'i drejtohen Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

10.4 Në çdo rast të kalimit të mosmarrëveshjeve, të lindura mes palëve në juridiksion gjyqësor, autorizohet njësia administruese dhe monitoruese e kontratës për ndjekjen e procedurës gjyqësore.

10.5 Kjo kontratë qiraje është e vlefshme deri në çastin, që prona publike e dhënë me qira privatizohet sipas akteve ligjore në fuqi.

Neni 11

Brenda një muaji nga nënshkrimi i saj, kontrata duhet të regjistrohet në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës.

Shpenzimet noteriale të kësaj kontrate i ngarkohen "qiramarrësit".

Kjo kontratë është formuluar në 7 (shtatë) kopje origjinale. Pasi iu lexua palëve, u kuptua, u pranua prej tyre, si dhe u nënshkrua para meje, me vullnetin e tyre të plotë e të lirë. Ndërsa, unë, noter _____, në bazë të nenit 801, e në vijim, të Kodit Civil, e vërtetoj atë si të rregullt.

QIRADHËNËSI	QIRAMARRËSI
Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit	**Fondacioni "Fundjavë Ndryshe"**

PRONARI SHTET: MM, Komanda Mbështetëse DATË 24 /04/2023 QËLLIMI Dhënie me qira

VENDNDODHJA
Bashkia Tiranë ZVASHK Tiranë Nr.Pasurisë 969/15 Z.K 1263 Indeksi i Hartës K-34-88-(220-D)

TE DHËNAT E PASURISË
Lloi i pasurisë Sip e pasurisë **16214m²** Sip e gjurmës së ndërtimit **3138.34m²** Nr. kateve 1 Nr. pemeve____

Nord =4583418.43 East = 488235.66 KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE (KRGJSH) Nord =4583418.43 East = 488675.57

Shpjeguese
Sip. e përgj. e pronës = **16 214.00 m²**
Sip. e përgj. nën objekte = **3 138.34 m²**
Kufiri i pronës

Objektet e Pronës nr. 98

Sip. e objektit nr.2	=	288.00 m² (rrënojë)
Sip. e objektit nr.3	=	95.70 m²
Sip. e objektit nr.4	=	34.40 m²
Sip. e objektit nr.5	=	192.00 m²
Sip. e objektit nr.6	=	193.60 m²
Sip. e objektit nr.8	=	192.00 m²
Sip. e objektit nr.9	=	6.25 m²
Sip. e objektit nr.10	=	296.32 m²(rrënojë)
Sip. e objektit nr.12	=	390.60 m²
Sip. e objektit nr.13	=	390.60 m²
Sip. e objektit nr.14	=	199.65 m²
Sip. e objektit nr.15	=	247.64 m²
Sip. e objektit nr.16	=	198.44 m²
Sip. e objektit nr.19	=	413.14 m² (rrënojë)

Nord =4583067.36 East = 488235.66 SH 1: 2500 METRA Nord =4583067.36 East = 488675.57

NR. ORJENTIMI	PERDORIMI	TIPI I KUFIRIT	KUFITARI	ID/NIPT
1 Veri				K51726024H
2 Lindje				
3 Jug				
4 Perëndim				

REALIZOI PËR IGJIU
Specialist Ramiz Haxhiu

KONFIRMOI PËR IGJIU
DREJTORI MArch. Teuta **KANXHERI**

REALIZOI PËR ASHK
Specialisti_____
DVASHK_____
Nënshkrimi_____
KONFIRMOI
Përgjegjësi/Drejtori_____
Nënshkrimi/ Vula_____

TEKNOLOGJIA E MATJEVE Z-Zyrë; O-Ortofoto; Azhornimit të kryer në terren.
PËRCAKTIMI I KUFIRIT: Sipas Hartës Kadastrale
Shënime : Ky planrilevim u hartua në zbatim të shkresës së Komandës Mbështetëse nr.2391/2, datë 13.04.2023 bazuar dokumentacionin hartografik arkivor, ortofoton e vitit 2015 marrë në geoportalin e ASIG-ut. Kufiri i pronës është hedhur sipas HTR b/lidhur shkresës.

PRONARI: SHTET MM (Komanda Mbështetëse)
MIRATOHET
KOMANDANTI I KOMANDËS MBËSHTETËSE
Gjeneral Brigade Ferdinant **DIMO**

VENDIM
Nr. 241, datë 17.4.2024

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 535, DATË 8.7.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PROCEDURAT, KRITERET DHE RREGULLAT PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT TË PUNËVE PUBLIKE NË KOMUNITET", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 11, të ligjit nr. 15/2019, "Për nxitjen e punësimit", me propozimin e ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 535, datë 8.7.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin e programit të punëve publike në komunitet", të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

I. Në kreun III bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Fjalia e parë, e pikës 1, ndryshohet, si më poshtë vijon:

"Punëkërkuesit me të drejtë përfitimi janë të gjithë punëkërkuesit e papunë të regjistruar në zyrën e punës, të moshës mbi 21 vjeç, të cilët evidentohen nga ndërveprimi me sistemin tatimor se kanë më shumë se 12 muaj të papunë, pasi të kenë marrë shërbimet e nevojshme të punësimit, të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.".

2. Pika 9 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"9. Punëdhënësit kanë të drejtë të aplikojnë për dy grupe maksimumi, me numër jo më të madh se 12 (dymbëdhjetë) punëkërkues të papunë secili grup.".

3. Pika 10 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"10. Punëdhënësi ka për detyrë të punësojë një mbikëqyrës për çdo grup përfituesish, nga 1 në 24 pjesëmarrës, i cili mund të punojë deri në 40 orë në javë.".

II. Në kreun IV bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"1. Për punëdhënësit përfitues, sipas shkronjave "a", "b" dhe "c", të pikës 4, të kreut III, financimi do të kryhet në formë granti, ndërsa për punëdhënësit sipas shkronjës "ç", të së njëjtës pike, financimi do të kryhet drejtpërdrejt në llogarinë e pjesëmarrësve përfitues në program.".

2. Në pikën 2 bëhen këto ndryshime:

a) Shkronja "b" ndryshohet, si më poshtë vijon:

"b) Kontributet e detyrueshme shoqërore dhe shëndetësore (pjesën e kontributeve të punëdhënësit dhe të punëmarrësit), të llogaritura në bazë të pagës minimale në shkallë vendi, të ofruara gjatë të gjithë kohëzgjatjes së programit.".

b) Në shkronjën "ç" bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

i. Në fjalinë e parë, pas fjalëve "... nën 6 vjeç, ..." shtohen "... personat me aftësi të kufizuara dhe ...";

ii. Në nënndarjen "i", fjalët "... 1 600 (një mijë e gjashtëqind) ..." zëvendësohen me "... 1 800 (një mijë e tetëqind) ...";

iii. Nënndarja "ii" ndryshohet, si më poshtë vijon:

"ii. për prindërit e vetëm ose prindërit e rinj të moshës 25–29 vjeç me fëmijë nën 6 (gjashtë) vjeç të jepet një bonus në vlerën prej 4 000 (katër mijë) lekësh në muaj për kujdesin e çdo fëmije në ngarkim.";

iv. Në nënndarjen "iii", të shkronjës "ç", të pikës 2, pas fjalës "... të kufizuara ..." shtohen fjalët "... , në të cilën përfshihen edhe mjetet ndihmëse në vendin e punës, literaturë/informacion të përshtatur dhe përkthime për personat me dëmtime shikimi ose dëgjimi, asistent personal në vendin e punës, transport të përshtatur, aksesueshmëri të mjedisit të punës ...".

3. Në shkronjën "a", të pikës 3, bëhen këto ndryshime:

a) Në nënndarjen "i", fjalët "... për grupin nga 1–7 punëkërkues të papunë pjesëmarrës ..." zëvendësohen me "... për grupin nga 1–12 punëkërkues të papunë pjesëmarrës ...";

b) Në nënndarjen "ii", fjalët "... për grupin nga 1–14 punëkërkues të papunë pjesëmarrës ..." zëvendësohen me "... për grupin nga 1–24 punëkërkues të papunë pjesëmarrës ...".

4. Pika 4 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"4. Për punëdhënësit përfitues, sipas shkronjave "a", "b" dhe "c", të pikës 4, të kreut III, granti financiar do të disbursohet në këste të pagueshme, si më poshtë vijon:

i. Kësti i parë: 30% (tridhjetë për qind) e vlerës totale të grantit të disbursuar me nënshkrimin e marrëveshjes;

ii. Kësti i dytë: 20% (njëzet për qind) e vlerës totale të grantit të disbursuar, pas muajit të dytë të zbatimit të programit;

iii. Kësti i tretë: 20% (njëzet për qind) e vlerës totale të grantit të disbursuar, pas muajit të gjashtë të zbatimit të programit;

iv. Kësti i katërt: 20% (njëzet për qind) e vlerës totale të grantit të disbursuar, pas muajit të nëntë të zbatimit të programit;

v. Kësti i fundit 10% (dhjetë për qind) me përfundimin e kontratës dhe të përmbushjes së të gjithë objektivave në planin individual të trajnimit.

Për punëdhënësit përfitues sipas shkronjës "ç", të pikës 4, të kreut III, të gjitha shpenzimet do të kryhen në llogarinë personale të përfituesve dhe degën e tatimeve përkatëse çdo muaj.".

III. Pika 13, e kreut V, shfuqizohet.

IV. Në pikën 5, të kreut VI, fjalët "... 5 (pesë) ..." zëvendësohen me "... 10 (dhjetë) ...".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 242, datë 17.4.2024

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 416, DATË 7.7.2023, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E KRITEREVE, RREGULLAVE DHE PROCEDURAVE PËR PËRFITIMIN E LEHTËSIRAVE FISKALE NGA ZHVILLUESIT DHE PËRDORUESIT QË OPEROJNË NË PARQET TEKNOLOGJIKE DHE SHKENCORE"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 12, të ligjit nr. 58/2022, "Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e parqeve teknologjike dhe shkencore", me propozimin e ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Fjalia e parë, e pikës 2, të kreut I, të vendimit nr. 416, datë 7.7.2023, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e kritereve, rregullave dhe procedurave për përfitimin e lehtësirave fiskale nga zhvilluesit dhe përdoruesit që operojnë në parqet teknologjike dhe shkencore", ndryshohet, si më poshtë vijon:

"Përdoruesi, duke përfshirë NIPT-in primar dhe sekondar të tij, që të përfitojë lehtësirat fiskale, duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:".

2. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 244, datë 17.4.2024

PËR MËNYRËN E ORGANIZIMIT E TË FUNKSIONIMIT TË KËSHILLIT KONSULTATIV TË QEVERISJES QENDRORE ME VETËQEVERISJEN VENDORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 12, të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Pushtetin Vendor, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

KREU I
QËLLIMI DHE NATYRA E ÇËSHTJEVE PËR KONSULTIM

1. Qëllimi i këtij vendimi është përcaktimi i rregullave për organizimin dhe funksionimin e Këshillit Konsultativ të Qeverisjes Qendrore me Vetëqeverisjen Vendore, përbërjen dhe funksionimin e tij, natyrën e çështjeve, objekt konsultimi, dhe procesin e këshillimit ndërmjet qeverisjes qendrore dhe vetëqeverisjes vendore për politikat, legjislacionin dhe normat që rregullojnë vetëqeverisjen vendore. Kuptimi i njësive të vetëqeverisjes vendore përcaktohet në nenin 5, të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar.

2. Objekt i konsultimit midis qeverisjes qendrore dhe vetëqeverisjes vendore, sipas këtij vendimi, janë

edhe funksionet dhe/ose kompetencat e deleguara pushtetit vendor, transferimi i funksioneve ose kompetencave të reja dhe propozimet e politikave për çështje që prekin interesat e pushtetit vendor, në përputhje me legjislacionin përkatës.

3. Njësitë e vetëqeverisjes vendore konsultohen të paktën 2 herë gjatë vitit kalendarik për financat e tyre, mjaftueshmërinë dhe stabilitetin e burimeve të tyre për arritjen e qëllimeve dhe kryerjen e shërbimeve të përcaktuara për to në ligjin nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar, dhe ligjet e tjera në fuqi.

4. Çështjet, të cilat janë objekt konsultimi midis qeverisjes qendrore dhe vetëqeverisjes vendore, sipas këtij vendimi, janë:

a) hartimi dhe zbatimi i politikave të decentralizimit dhe monitorimi i realizimit të tyre;

b) hartimi dhe zbatimi i politikave fiskale e financiare vendore, përfshirë transfertat ndërqeveritare, dhe financimi i qeverisjes vendore nga buxheti i shtetit;

c) funksionet e bashkive, sipas parashikimit të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar;

ç) hartimi dhe zbatimi i politikave rajonale dhe harmonizimi i tyre me politikat shtetërore në nivel vendor e nivel qarku;

d) funksionet dhe kompetencat e këshillit të qarkut dhe çdo funksion tjetër të dhënë me ligj;

dh) nxitja e bashkëpunimit rajonal e ndërkufitar, me objekt zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik të zonave ndërkufitare;

e) çdo çështje tjetër që është në interesin e ndërsjellë të qeverisjes qendrore dhe/ose qeverisjes vendore.

KREU II
PARIMET E PROCESIT TË KONSULTIMIT

5. Procesi i konsultimit në Këshillin Konsultativ të Qeverisjes Qendrore me Vetëqeverisjen Vendore bazohet në:

a) parimin e informimit, nëpërmjet njoftimit dhe vënies në dispozicion të anëtarëve të Këshillit Konsultativ, shoqatave përfaqësuese të njësive të vetëqeverisjes vendore dhe, nëpërmjet tyre, të gjitha njësive të vetëqeverisjes vendore të projektligjeve, projektvendimeve, projektpolitikave ose projektstrategjive që propozohen nga qeverisja qendrore;

b) parimin e konsultimit, nëpërmjet shkëmbimit të mendimeve, komenteve, vërejtjeve dhe propozimeve për projektligjet, projektaktet nënligjore, projektpolitikat ose projektstrategjitë të propozuara nga qeverisja qendrore dhe që kanë ndikim në ushtrimin e të drejtave dhe funksioneve të njësive të vetëqeverisjes vendore;

c) parimin e angazhimit të shoqatave përfaqësuese të njësive të vetëqeverisjes vendore dhe të vetë këtyre njësive, nëpërmjet përfshirjes së tyre në procesin e formulimit e të miratimit të projektakteve, politikave, si dhe nëpërmjet propozimeve ligjore për përmirësimin e vazhdueshëm të akteve që lidhen me decentralizimin dhe qeverisjen vendore;

ç) parimin e bashkëpunimit dhe dialogut konstruktiv me të gjitha shoqatat përfaqësuese të njësive të vetëqeverisjes vendore.

KREU III
KRIJIMI, PËRBËRJA DHE DREJTIMI I KËSHILLIT KONSULTATIV TË QEVERISJES QENDRORE ME VETËQEVERISJEN VENDORE

6. Me qëllim arritjen dhe institucionalizimin e procesit të konsultimit midis qeverisjes qendrore dhe vetëqeverisjes vendore funksionon Këshilli Konsultativ i Qeverisjes Qendrore me Vetëqeverisjen Vendore, i cili është forumi kryesor ku qeverisja qendrore konsultohet me njësitë e vetëqeverisjes vendore për projektligjet, projektvendimet e Këshillit të Ministrave, projektpolitikat dhe projektstrategjitë që rregullojnë ose kanë ndikim të drejtpërdrejtë në ushtrimin e të drejtave dhe detyrimeve të njësive të vetëqeverisjes vendore.

7. Përbërja e Këshillit Konsultativ të Qeverisjes Qendrore me Vetëqeverisjen Vendore është në përfaqësim të barabartë anëtarësh, 11 (njëmbëdhjetë) përfaqësues të qeverisjes qendrore dhe 11 (njëmbëdhjetë) përfaqësues të vetëqeverisjes vendore, si më poshtë vijon:

a) ministri përgjegjës për pushtetin vendor;

b) zëvendësministri përgjegjës për fushën e financave vendore;

c) zëvendësministri përgjegjës për çështjet e drejtësisë;

ç) zëvendësministri përgjegjës për energjinë dhe infrastrukturën;

d) zëvendësministri përgjegjës për çështjet sociale;

dh) zëvendësministri përgjegjës për ekonominë, kulturën dhe inovacionin;

e) zëvendësministri përgjegjës për bujqësinë dhe zhvillimin rural;

ë) zëvendësministri përgjegjës për mjedisin dhe turizmin;

f) zëvendësministri përgjegjës për arsimin;

g) zëvendësministri përgjegjës për punët e brendshme;

gj) përfaqësuesi i ministrit të Shtetit dhe Kryenegociator;

h) kryetari i Shoqatës për Autonomi Vendore dhe 6 (gjashtë) kryetarë bashkie, përfaqësues të Shoqatës për Autonomi Vendore;

i) kryetari i Shoqatës së Qarqeve dhe 3 (tre) kryetarë të këshillit të qarkut, përfaqësues të Shoqatës së Qarqeve.

8. Të gjithë anëtarët e sipërpërmendur konfirmojnë praninë e tyre duke njoftuar sekretariatin teknik në rrugë zyrtare/elektronike 3 ditë pune para ditës së zhvillimit të mbledhjes.

9. Anëtarët, të cilët nuk mund të marrin pjesë në takim për shkaqe objektive të angazhimeve, caktojnë përfaqësuesin e tyre zëvendësues, 3 ditë pune para ditës së zhvillimit të mbledhjes. Anëtarët mund të caktojnë përfaqësuesin e tyre zëvendësues në jo më shumë se 3 mbledhje të Këshillit Konsultativ në vit. Përfaqësuesi i caktuar për të marrë pjesë në takim duhet të jetë zyrtar i nivelit të lartë/të mesëm drejtues.

10. Në mbledhjet e Këshillit Konsultativ mund të ftohen të marrin pjesë kryesia e Komisionit Përgjegjës për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut në Kuvendin e Shqipërisë, kryetari i Nënkomisionit të Përhershëm Parlamentar për Qeverisjen Vendore, anëtarë të tjerë të Këshillit të Ministrave apo përfaqësues të tyre, prefektët e qarqeve apo përfaqësues të veprimtarisë së tyre, përfaqësues të sektorit të kontrollit të ndihmës shtetërore pranë ministrisë përgjegjëse të ekonomisë, përfaqësues të organizmave dhe programeve ndërkombëtare me fokus veprimtarinë e qeverisjes vendore, si dhe drejtues të institucioneve kushtetuese ose institucioneve të tjera qendrore që kanë lidhje me çështjet, objekt konsultimi.

11. Mbledhjet e Këshillit Konsultativ bashkëdrejtohen nga ministri përgjegjës për pushtetin vendor dhe një nga kryetarët e shoqatave përfaqësuese të pushtetit vendor. Kryetarët e shoqatave përfaqësuese të pushtetit vendor drejtojnë Këshillin Konsultativ mbi bazën e rotacionit, për 6 muaj kalendarikë, duke filluar nga shoqata përfaqësuese me numrin më të madh të anëtarëve.

12. Në veçanti, mbledhjet e Këshillit Konsultativ për çështjet e financave vendore, sipas shkronjës "b", të pikës 4, të kreut I, bashkëkryesohen nga ministri i Financave dhe/ose zëvendësministri i Financave me delegim të ministrit të Financave dhe në të përveç anëtarëve të përhershëm të këshillit marrin pjesë edhe përfaqësues të tjerë nga stafi teknik i Ministrisë së Financave.

13. Mbledhjet e Këshillit Konsultativ zhvillohen të hapura. Në raste të veçanta, mbledhjet e këshillit mund të zhvillohen edhe të mbyllura, kur për këtë bien dakord dy bashkëkryetarët.

KREU IV
PROCEDURA E KONSULTIMIT TË AKTEVE DHE MBLEDHJET E KËSHILLIT

SEKSIONI I
PROCEDURA E KONSULTIMIT TË AKTEVE

14. Projektligjet, projektvendimet, projektpolitikat ose projektstrategjitë, që lidhen me fushën e funksioneve të vetëqeverisjes vendore sipas neneve 12, 23, 24, 25, 26, 27, 28, 29, 30, 31, 32, 33, 34–43, të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar, si dhe çdo projektakt tjetër që përfshihet në fushën e veprimit të këtij vendimi, i dërgohen në formë elektronike e të shkruar Sekretariatit Teknik të Këshillit Konsultativ prej sekretarëve të përgjithshëm të institucioneve propozuese të projektaktit.

15. Me marrjen e tyre, Sekretariati Teknik i shfaq ato brenda tri ditësh pune në faqen zyrtare të internetit të Këshillit Konsultativ dhe në formë elektronike ia dërgon çdo anëtari të Këshillit Konsultativ.

16. Projektaktet, që nuk paraqiten nga relatorët në formën e duhur të prezantimit, nuk do të jenë pjesë e agjendës së mbledhjes së Këshillit, me përjashtim të projektakteve me rëndësi strategjike kombëtare.

17. Afati, brenda të cilit anëtarët e Këshillit Konsultativ dhe njësitë e tjera të vetëqeverisjes vendore mund të paraqesin vërejtjet, mendimet,

komentet dhe propozimet e tyre, është 15 ditë kalendarike nga e nesërmja e dërgimit të projektaktit anëtarëve të Këshillit Konsultativ.

18. Në përfundim të këtij afati, brenda 5 ditësh pune, Sekretariati Teknik organizon punën për përgatitjen e përmbledhjes sipas mendimeve, komenteve, vërejtjeve dhe propozimeve të paraqitura dhe ia dërgon ato propozuesit të projektaktit dhe anëtarëve të Këshillit Konsultativ. Një kopje e tyre shfaqet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit Konsultativ.

19. Institucioni propozues nuk vijon procedurën e miratimit të projektaktit deri në marrjen e komenteve, mendimeve, vërejtjeve dhe propozimeve nga Sekretariati Teknik i Këshillit Konsultativ ose mbarimit të afatit për paraqitjen e tyre.

SEKSIONI II
MBLEDHJET E KËSHILLIT KONSULTATIV

20. Këshilli Konsultativ zhvillon aktivitetin e tij nëpërmjet:

a) konsultimit dhe komunikimit *online*;

b) mbledhjeve të punës;

c) mbledhjeve plenare.

21. Mbledhjet e punës dhe plenare të Këshillit zhvillohen në prani të më shumë se gjysmës të të gjithë anëtarëve të tij. Për mospjesëmarrjen e anëtarëve njoftohen titullarët e institucioneve të përfaqësuara në Këshillin Konsultativ. Prezenca e tyre do të pasqyrohet në dokumentacion dhe në *web*-faqen e Këshillit Konsultativ.

22. Bashkëkryetarët e Këshillit Konsultativ kujdesen për organizimin dhe funksionimin e Këshillit dhe kryerjen e detyrave të tij sipas këtij vendimi. Rendi i ditës së mbledhjes së Këshillit Konsultativ dhe materialet shoqëruese të tyre bëhen kurdoherë publike në faqen e internetit të Këshillit.

23. Në bashkëpunim me Sekretariatin Teknik, bashkëkryetarët e Këshillit Konsultativ mund të thërrasin mbledhje pune të tij, e cila zhvillohet jo më herët se 7 ditë pune nga data e marrjes së njoftimit të mbledhjes nga anëtarët e Këshillit.

24. Bashkëkryetarët e Këshillit Konsultativ janë të detyruar të thërrasin mbledhjen e Këshillit në rast se jo më pak se 8 anëtarë të tij e kërkojnë me shkrim këtë gjë. Kërkuesit duhet të paraqesin në këtë rast rendin e ditës dhe materialet shoqëruese të tij. Mbledhja e punës zhvillohet jo më herët se 7 ditë pune nga data e depozitimit të kërkesës për thirrjen e mbledhjes.

25. Mbledhjet plenare të Këshillit Konsultativ zhvillohen në muajin mars dhe muajin tetor të çdo viti kalendarik. Rendi i ditës së mbledhjes plenare të Këshillit Konsultativ përcaktohet nga ministri përgjegjës për çështjet vendore në bashkëpunim me shoqatat përfaqësuese të njësive të vetëqeverisjes vendore.

26. Rendi i ditës së mbledhjes plenare të muajit mars është për diskutimin e masave për mbarëvajtjen e sezonit turistik.

27. Rendi i ditës së mbledhjes plenare të muajit tetor është vetëm për projektligjin e buxhetit të shtetit dhe projektligjet financiare që lidhen drejtpërdrejt me buxhetin e njësive të vetëqeverisjes vendore.

28. Me vendim të bashkëkryetarëve të Këshillit Konsultativ ose me vendim të Këshillit Konsultativ mund të krijohen komisione këshillimi, si struktura *ad hoc* për të mbuluar fusha dhe sektorë specifikë që lidhen me funksionet e vetëqeverisjes vendore të përcaktuara në ligjin nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar. Komisionet e këshillimit janë të përkohshme dhe përfundojnë funksionimin e tyre me kryerjen e detyrave që u janë ngarkuar. Në aktin e krijimit të komisioneve të këshillimit përcaktohen kryesuesi i tij dhe detyrat e ngarkuara.

29. Mbledhjet e Këshillit Konsultativ organizohen në Tiranë. Me miratimin e bashkëkryetarëve, mbledhjet mund të organizohen dhe në qytete të tjera.

30. Në mbledhjet e punës dhe mbledhjet plenare të Këshillit Konsultativ vendimet merren me shumicën e votave të përfaqësuesve pjesëmarrës në mbledhje. Në përfundim të mbledhjeve, Këshilli Konsultativ mund të miratojë rekomandime konkrete drejtuar institucioneve të qeverisjes qendrore apo institucioneve të tjera publike. Mendimet e përfaqësuesve të njësive të vetëqeverisjes vendore, në mbështetje ose jo të projektakteve të propozuara të qeverisjes qendrore, i bashkëlidhen praktikës dokumentare që shoqëron procesin vijues të vendimmarrjes përkatëse në Këshillin e Ministrave ose në Kuvend.

31. Projektaktet, që propozohen për miratim, duhet të përshkruajnë në relacionin shoqërues zbatimin e procedurës së konsultimit sipas këtij

vendimi dhe arsyet e mosreflektimit të vërejtjeve të paraqitura në përfundim të këtij konsultimi.

KREU V
SEKRETARIATI TEKNIK

32. Pranë Këshillit Konsultativ funksionon Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore që kryen funksione ndihmëse dhe administrative në rolin e sekretariatit teknik. Për kryerjen e funksioneve të sekretariatit teknik, AMVV-ja mund të mbështetet edhe nga donacione të ndryshme, si dhe nga çdo burim tjetër financiar i ligjshëm.

33. Sekretariati Teknik kryen këto detyra:

a) Administron faqen zyrtare të internetit të Këshillit Konsultativ;

b) Grumbullon dhe përpunon komentet, vërejtjet, sugjerimet dhe propozimet e anëtarëve të Këshillit Konsultativ dhe njësive të tjera të vetëqeverisjes vendore në procesin e konsultimit;

c) U dërgon anëtarëve të Këshillit Konsultativ, Këshillit të Ministrave, ministrive përkatëse ose institucioneve të tjera shtetërore informacionin e përpunuar dhe dokumentacionin shoqërues;

ç) Zbaton rekomandimet e Këshillit Konsultativ;

d) Ndihmon dhe mbështet Këshillin Konsultativ me analizën ligjore dhe teknike në lidhje me projektaktet e paraqitura, si dhe në punën dhe mbarëvajtjen e takimeve;

dh) Ndihmon dhe mbështet Këshillin Konsultativ duke organizuar mbledhje;

e) Me kërkesë të bashkëkryetarëve ose të Këshillit Konsultativ përgatit raporte dhe studime për çështje që lidhen me fushën e veprimtarisë së Këshillit;

ë) Kujdeset për mbajtjen e procesverbaleve të mbledhjeve të punës dhe mbledhjeve plenare të Këshillit Konsultativ dhe i publikon ato në faqen e internetit;

f) Përgatit informacion periodik për veprimtarinë e Këshillit Konsultativ;

g) Është përgjegjës për kryerjen e njoftimeve për anëtarët e Këshillit Konsultativ;

gj) Me propozim të Këshillit Konsultativ, njofton njësitë e vetëqeverisjes vendore që të kërkojnë autorizimin e Komisionit të Ndihmës Shtetërore në rastin e financimit me fonde publike apo lehtësi tjetër të dhënë prej tyre për kryerjen e funksioneve të bashkive në fushën e zhvillimit ekonomik vendor;

h) Në fund të çdo viti kalendarik, Sekretariatit Teknik i vihen në dispozicion nga ana e ministrive projektaktet e përfshira në programin analitik të vitit pasaardhës, për aq sa ato kanë të bëjnë me qeverisjen vendore dhe decentralizimin;

i) Sekretariati Teknik organizon panele diskutimi dhe konsultimi për tematika specifike me anëtarët e Këshillit Konsultativ, përgjegjës për fushat e përgjegjësive që trajtohen në këto seanca;

j) Kryen detyra të tjera të përcaktuara nga Këshilli Konsultativ ose në këtë vendim.

KREU VI
DISPOZITA TË FUNDIT

34. Këshilli Konsultativ i Qeverisjes Qendrore me Vetëqeverisjen Vendore miraton rregulloren e brendshme të organizimit dhe funksionimit.

35. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 910, datë 21.12.2016, "Për çështjet, objekt konsultimi, dhe strukturën, procedurën, formën, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Këshillit Konsultativ të Qeverisjes Qendrore me Vetëqeverisjen Vendore", të ndryshuar, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 246, datë 17.4.2024

PËR HAPJEN E MISIONIT DIPLOMATIK TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË REPUBLIKËN E INDISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 21, të ligjit nr. 23/2015, "Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë", me propozimin e ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Hapjen e misionit diplomatik "Ambasadë" të Republikës së Shqipërisë në kryeqytetin e Republikës së Indisë, Nju-Delhi.

2. Shpenzimet për hapjen e këtij misioni diplomatik përballohen nga buxheti i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, miratuar për vitin 2024.

3. Ngarkohet Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 247, datë 17.4.2024

PËR HAPJEN E MISIONIT DIPLOMATIK TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË REPUBLIKËN E KENIAS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 21, të ligjit nr. 23/2015, "Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë", me propozimin e ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Hapjen e misionit diplomatik "Ambasadë" të Republikës së Shqipërisë në kryeqytetin e Republikës së Kenias, Nairobi.

2. Shpenzimet për hapjen e këtij misioni diplomatik përballohen nga buxheti i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, miratuar për vitin 2024.

3. Ngarkohet Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 248, datë 17.4.2024

PËR HAPJEN E MISIONIT DIPLOMATIK TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË REPUBLIKËN E INDONEZISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 21, të ligjit nr. 23/2015, "Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë", me propozimin e ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Hapjen e misionit diplomatik "Ambasadë" të Republikës së Shqipërisë në kryeqytetin e Republikës së Indonezisë, Xhakarta.

2. Shpenzimet për hapjen e këtij misioni diplomatik përballohen nga buxheti i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, miratuar për vitin 2024.

3. Ngarkohet Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

UDHËZIM
Nr. 5, datë 8.4.2024

PËR PËRCAKTIMIN E KUFIRIT FINANCIAR TË VLERËS SË PLOTË TË PROJEKTIT, NË PËRPUTHJE ME SPECIFIKAT E SEKTORIT, MBI BAZËN E TË CILIT PËRCAKTOHET MËNYRA DHE PROCEDURA E VLERËSIMIT TË PROJEKTIT TË INVESTIMIT PUBLIK

Në përputhje me nenin 25, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; pikën 2, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 887, datë 27.12.2022, "Për procedurat e menaxhimit të investimeve publike", ministri i Financave

UDHËZON:

1. Çdo propozim për projekt investimesh publike, që ka një vlerë të plotë mbi kufirin e përcaktuar sipas lidhjes nr. 1, duhet t'i nënshtrohet një procesi të plotë vlerësimi përpara fillimit të procesit buxhetor.

2. Udhëzimi nr. 4, datë 20.2.2023, "Për përcaktimin e kufirit financiar të vlerës së plotë të projektit, në përputhje me specifikat e sektorit, mbi bazën e të cilit përcaktohet mënyra dhe procedura e vlerësimit të projektit të investimit publik", shfuqizohet.

3. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I FINANCAVE
Ervin Mete

Tabela 1: Klasifikimi i Projekteve Strategjike

SEKTORI	PËRSHKRIMI	NËNSEKTORI	VLERA
Digjital	Infrastruktura Digjitale, i referohet teknologjive digjitale, të cilat ofrojnë bazën për teknologjinë dhe operacionet e informacionit të një njësie organizative. Do të konsiderohen si pjesë e Sektorit të Infrastrukturës Digjitale të gjitha projektet e investimit, rezultatet e të cilave synohet të kenë ndikim parësor në të paktën një prej nen-sektorëve të këtij sektori.	Ndërlidhja me Bazë të Gjerë	Mbi 700,000,000 Lekë
		Infrastruktura e-GOV	
		Sisteme informacioni	
		Platformat e Inovacionit	
Zhvillimi Ekonomik	Zhvillimi Ekonomik, i referohet programeve dhe politikave, apo aktiviteteve ekonomike, të cilat kanë për qëllim të përmirësojnë mirëqenien ekonomike dhe cilësinë e jetës së burrave dhe grave të komunitetit në vend. Do të konsiderohen si pjesë e Sektorit të Zhvillimit Ekonomik të gjitha projektet e investimit, rezultatet e të cilave synohet të kenë ndikim parësor në të paktën një prej nënsektorëve të këtij sektori.	Agrikultura	Mbi 700,000,000 Lekë
		Zhvillimi i Biznesit	
		Infrastruktura Bregdetare dhe Detare	
		Sipërmarrja	
		Industria	
		Zhvillimi Rajonal	
		Turizmi	
Energjia	Energjia, i referohet aktiviteteve ekonomike me impakt në prodhimin dhe shitjen e energjisë, përfshirë nxjerrjen e karburanteve, përpunimin dhe shpërndarjen e tyre. Do të konsiderohen si pjesë e Sektorit të Energjisë të gjitha projektet e investimit, rezultatet e të cilave synohet të kenë ndikim parësor në të paktën një prej nënsektorëve të këtij sektori.	Eficenca e Energjisë	Mbi 1,200,000,000 Lekë
		Prodhimi I Energjisë	
		Transmetimi I Energjisë	
		Gazi	
		Nafta	
		Energjia e Rinovueshme	
Mjedisi	Mjedisi, i referohet aktiviteteve ekonomike të cilat kanë për qëllim mbrojtjen e mjedisit dhe menaxhimin e burimeve natyrore. Do të konsiderohen si pjesë e Sektorit të Mjedisit të gjitha Projektet e Investimit, rezultatet e të cilave synohet të kenë ndikim parësor në të paktën një prej nënsektorëve të këtij sektori.	Menaxhimi I Fatkeqësive	Mbi 700,000,000 Lekë
		Mbrojtja nga Përmbytjet	
		Zhvillimi I Qëndrueshëm	
		Menaxhimi I Mbetjeve, Landfillet	
		Furnizimi me Ujë	
Social	Sektori Social, i referohet programeve dhe politikave, apo aktiviteteve ekonomike, të cilat kanë për qëllim reduktimin e shtrirjes së varfërisë dhe përmirësimin e cilësisë së jetesës së burrave dhe grave të në vend si dhe adresimin e pabarazive gjinore në përgjithësi. Do të konsiderohen si pjesë e Sektorit Social të gjitha projektet e investimit, rezultatet e të cilave synohet të kenë ndikim parësor në të paktën një prej nënsektorëve të këtij sektori.	Kultura	Mbi 700,000,000 Lekë
		Edukimi dhe Sportet	
		Shëndetësia	
		Strehimi	
		Siguria e Brendshme	
		Drejtësia	
		Mbrojtja Sociale	
Transporti	Transporti, I referohet aktiviteteve ekonomike, të cilat kanë për qëllim zhvillimin apo përmirësimin e infrastrukturës ekzistuese të transportit të mallrave dhe / ose qytetarëve nëpërmjet tokës, ujërave dhe ajrit. Do të konsiderohen si pjesë e të Transportit të gjitha projektet e investimit, rezultatet e të cilave synohet të kenë ndikim parësor në të paktën një prej nënsektorëve të këtij sektori.	Transporti Ajror	Mbi 2,500,000,000 Lekë
		Transporti në Ujërat e Brendshme, Portet	
		Transporti Hekurudhor	
		Transporti Rrugor	

VENDIM
Nr. 49, datë 12.4.2024

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË LARTË TË PROKURORISË NR. 91, DATË 13.5.2019, "PËR PAGESAT E PROKURORËVE PËR PUNËN E KRYER JASHTË ORARIT"

Bazuar në nenin 149/a, pika 1, shkronja "e", të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; në nenin 11, pika 3, germa "ç", të ligjit nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar; nenet 159, pika 2, germa "e", 188, pika 1, dhe 189, të ligjit nr. 115/2016, "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", të ndryshuar; nenin 40, të ligjit nr. 97/2016, "Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar; nenin 56, të ligjit nr. 95/2016, "Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar", të ndryshuar, me propozim të Komisionit të Planifikimit Strategjik, të Administrimit dhe Buxhetit, Këshilli i Lartë i Prokurorisë

VENDOSI:

I. Neni 7, pikat 2 dhe 3, të vendimit nr. 91, datë 13.5.2019, "Për pagesat e prokurorëve për punën e kryer jashtë orarit", ndryshojnë, si më poshtë:

"2. Prokurori që ushtron funksionin në ditët e pushimit javor apo festave zyrtare, si dhe orët shtesë të kryera në orarin 22:00–06:00, për veprime të natyrës urgjente, përfiton shtesë page në masën 50% të pagës së tij ditore në përpjesëtim me orët e punës së kryer ose kompensim me kohë pushimi, por duhet të provojë me dokumentacion shoqërues (aktet hetimore ose vendime të gjykatës) orët e punës së kryer.

3. Prokurori që ushtron funksionin jashtë kohës normale të punës për veprime të natyrës urgjente, përfiton shtesë page në masën 25% të pagës së tij ditore në përpjesëtim me orët e punës së kryer ose kompensim me kohë pushimi, por duhet të provojë me dokumentacion shoqërues (aktet hetimore ose vendime të gjykatës) orët e punës së kryer."

II. Neni 8, i këtij vendimi, ndryshon, si më poshtë:

"1. Prokurori që është në gatishmëri sipas grafikut të përcaktuar nga drejtuesi i prokurorisë, për shkak të gatishmërisë gjatë ditëve të festave zyrtare apo ditëve pushim përfiton shtesë page në masën 50% të pagës së tij ditore ose kompensim me kohë pushimi sipas pikës 4 të nenit 7.

2. Prokurori i cili është i gatshëm gjatë ditëve të javës por për shkak të gatishmërisë del jashtë orarit zyrtar të asaj dite përfiton shtesë page në masën 25% të pagës së tij ditore ose kompensim me kohë pushimi në përpjesëtim me orët e punës së kryer sipas pikës 4 të nenit 7, por duhet të provojë me dokumentacion shoqërues (aktet hetimore ose vendime të gjykatës) orët e punës së kryer.

3. Prokurori që është i gatshëm gjatë ditëve të javës, por për shkak të gatishmërisë kryen veprime në orarin 22:00–06:00, përfiton shtesë page në masën 50% të pagës së tij ditore në përpjesëtim me orët e punës së kryer ose kompensim me kohë pushimi në përpjesëtim me orët e punës së kryer, sipas pikës 4, të nenit 7, por duhet të provojë me dokumentacion shoqërues (aktet hetimore, vendime të gjykatës etj.) punën e kryer gjatë këtij orari."

III. Në nenin 9 shfuqizohet fjalia e dytë e paragrafit me këtë përmbajtje:

"Fondi i përcaktuar për orët jashtë orarit nuk duhet të tejkalojë më shumë se 200 orë në vit për çdo prokuror".

IV. Ky vendim hyn në fuqi në datën e botimit në Fletoren Zyrtare dhe publikohet në faqen zyrtare web të Këshillit.

V. U shpall në Tiranë, sot, më 12.4.2024.

ZËVENDËSKRYETAR
Tartar Bazaj

	Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2024

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 336 lekë

Vulosur elektronikisht nga Qendra e Botimeve Zyrtare
Date:2024/04/19 12:47:21 +02'00'
954911202404191247128703 1

Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një proçedure automatike nga një sistem elektronik (Qendra e Botimeve Zyrtare)